

Durres, me 05.07.2022

## Kujtesë

### I nderuar Klient:

Ligji 7/2022 date 27.01.2022, i cili është në ndryshim të ligjit 9723 date 03.05.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit” dhe që ka hyrë në fuqi me datën 01.03.2022, dhe konsiston në rritjen e penalteteve që vendos QKB-ja nga 15.000 leke që ishte në vlerën 60.000 leke

Keto penaltete janë për mos regjistrimin e të dhënave në afat dhe të dhënave të pa verteta.

Në lidhje me dorëzimin e bilanceve do ndaleshim në ceshtjet si mëposhte vijon:

#### **1. Kur PF nuk janë nënshkruar nga Hartuesi (Financieri)**

Kjo kërkesë është e Ligjit 25/2018 dt. 10.05.2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” nëni 23 pika 3 ku thuhet:

***3. Pasqyrat financiare nënshkruhen nga përfaqësuesi ligjor i njësisë ekonomike dhe personi përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare.***

Kete kërkesë ligjore nuk e zëvendëson as deklaratat që dorëzohet të tatimet për mbajtësin e kontabilitetit dhe as deklarimi që bëhet gjatë dorëzimit të bilancit të kërkesat e deklarimit.

#### **2. Dorëzimin e detyrueshëm për:**

- a) pasqyrat financiare vjetore,
- b) raportin e ecurisë së veprimtarisë,
- c) raportin e konsoliduar të ecurisë së veprimtarisë,
- d) raportin e auditimit.

Keto kërkesa vë nën Ligji nr. 25/2018 date 10.05.2018, “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, konkretisht nëni 22, pika 1, në të cilin përcaktohet se:

1. Njësitë ekonomike, brenda 7 muajve nga data e raportimit, depozitojnë për publikim pranë autoritetit përkatës ku janë regjistruar, pasqyrat financiare vjetore, raportin e ecurisë së veprimtarisë/raportin e konsoliduar të ecurisë së veprimtarisë, raportin e auditimit, në rastet kur përgatitja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

### **3. Dorzimin e detyrueshem te vendimit te miratimit te bilancit:**

#### **Terheqim vemendjen qe:**

Te tregohet kujdes gjate dorezimit te bilancit per te shmangur penalitetet e pa nevojeshme.

Me konsiderate

**Luan GOSNISHTI**

Auditues Ligjor

.....

## **K u a d r i   L i g j o r**

**Ligji 9723, dt. 03.05.2007,**

**“Për Regjistrimin e Biznesit”**

Neni 74

**Kundërvajtjet administrative**

1. Subjekti përgjigjet, sipas ligjeve në fuqi, për vërtetësinë e fakteve, të të dhënave të njoftuara dhe të dokumenteve shoqëruese, të depozituara në regjistër.

2. Deklarimi në regjistër i të dhënave të pavërteta, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 15 000 lekë.

2. Deklarimi në regjistër i të dhënave të pavërteta, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.

3. Moskryerja e detyrimit për regjistrimin fillestar dhe regjistrimet e tjera të detyrueshme, brenda afateve të parashikuara nga ky ligj, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 15 000 lekë.

3. Moskryerja e detyrimit për regjistrimin fillestar dhe regjistrimet e tjera të detyrueshme brenda afateve të parashikuara nga ky ligj, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.

4. Gjoba aplikohet nga titullari i QKR-së, vendimi i të cilit ankimohet drejtpërdrejt në gjykatë.

---

**Ligji 7/2022 dt. 27.01.2022**  
**Per nje ndryshim ne Ligjin 9723, dt. 03.05.2007,**  
**“Për Regjistrimin e Biznesit”**

**Neni 1**

Në nenin 74 pikat 2 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:

“2. Deklarimi në regjistër i të dhënave të pavërteta, kur nuk përbën vepr penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.

3. Moskryerja e detyrimit për regjistrimin fillestar dhe regjistrimet e tjera të detyrueshme brenda afateve të parashikuara nga ky ligj, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.”.

**Neni 2**

**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 27.1.2022.

**Shpallur me dekretin nr. 13470, date 11.2.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.**

Botuar ne F.Zyrtare 25/2022

Dale nga shtypi me 15.02.2022

---

**Ligji 25/2018 date 10.05.2018**  
**Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare**

Neni 22

**Depozitimi dhe publikimi i pasqyrave financiare**

1. Njësitë ekonomike, brenda 7 muajve nga data e raportimit, depozitojnë për publikim pranë autoritetit përkatës ku janë regjistruar, pasqyrat financiare vjetore, raportin e ecurisë së veprimtarisë/raportin e konsoliduar të ecurisë së veprimtarisë, raportin e auditimit, në rastet kur përgatitja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Neni 23

**Përgjegjësitë**

3. Pasqyrat financiare nënshkruhen nga përfaqësuesi ligjor i njësisë ekonomike dhe personi përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare.

---